



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenin 57 shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, si dhe bazuar në ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji nr. 02/L-52, Ligji nr.03/L-068, Ligji nr.04/L-32 dhe Ligji nr.04/L-138), dhe me qëllim të mënjanimit të subjektivizmit, joprofesionalizmit dhe familjarizimit me rastin e pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore (IP) publike të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr këtë:

V E N D I M
PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET
PARASHKOLLORE PUBLIKE

1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të komunës së Prishtinës mund të regjistrohen në institucionet parashkollore (IP), të Komunës së Prishtinës.
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukurore të IP-ve.
3. Moshë minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në IP e përcaktojnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukurore të IP-ve, por llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marr parasysh datën e regjistrimit por datën e fillimit të shërbimit, përkatësisht duke marr parasysh **datën 31 tetor**.
4. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	80
4	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	30
6	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	20
7	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit punojnë	80
8	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind punon	60
9	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk punon	40
10	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar	30
12	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	15
14	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	10
15	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	40
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	30
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	25
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve mbi 1000 euro)	20
19	Fëmijët e prindërve që janë banues në lagjen – Bashkësinë Lokale ku gjendet IP-ja	20
20	Fëmijët e punëtorëve të IP-ve	10
21	Fëmijët e prindërve që tashmë e kanë një fëmijë vijues në IP	10
22	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit deri në 350 euro)	20
23	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 351 - 700 euro)	15
24	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 701 - 1000 euro)	10
25	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit mbi 1000 euro)	5

5. Të gjitha statutet e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante.

Faqe 2 nga 3

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 03 nr.69, dt.05.06.2018, Për kriteret e pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike.

7. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

**Kryetarit të Komunës
Drejtorive të IEAA
DKA-së
QSHQK-së**

**Drejtoria e Arsimit
Drejtoreshë
Shpresa Shala
19 qershor 2020**



Faqe 3 nga 3